Informata të përgjithshme për Jo rezidentët

Personat

Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) janë marrëveshje bilaterale në mes të dy shteteve me qëllim të parandalimit të tatimimit të dyfishtë mbi të ardhura dhe kapital, parandalimi i evazionit fiskal dhe diskriminimin tatimor si dhe mundësia për zgjidhjen e kontesteve tatimore.
Në praktikë, këto marrëveshje shpesh i hasim me terma të ndryshëm si: "konventa", "marrëveshje", "traktate tatimore".
Të hyrat e realizuara në vende të ndryshme, përtej kufijve shtetëror mund të jenë subjekt potencial i tatimit si i asaj që dy shtetet pretendojnë të tatimojnë të njëjtat të hyra.

"Person" nënkupton një individ, një ndërmarrje dhe çdo grup të personave.

Për të pasur qasje një person në METD specifike p.sh. në atë mes Kosovës dhe Shteti X ai person duhet të jetë rezident në njërin shtet kontraktues. Për të dëshmuar këtë nevojitet të dëshmohet me Certifikatën e Rezidencës Tatimore të lëshuar nga Autoriteti Tatimor i të cilët është rezident personi.
Certifikata e Rezidencës Tatimore është dokument i cili lëshohet nga Autoriteti i shtetit të rezidencës tatimore për të dëshmuar se personi është rezident i atij vendi dhe për të ardhurat nga e mbarë bota do të deklaroj dhe paguaj tatimet në vendin e rezidencës.
Taturja e të ardhurave për personat jo rezident varet edhe nga fakti nëse kemi METD të zbatueshme me shtetin në fjalë.

Jo rezidentët – personi fizik
Sa i përket të drejtës tatimore të personave Jo rezident të cilët aktualisht janë të punësuar në vendin tonë ajo ndryshon si në vijim:

1) **Marrëveshjet për eliminim të tatimit të dyfishtë (METD) në fuqi**! Në rastet kur ekziston METD me shtetin në fjalë: atëherë çështja e tatimimit për këtë person i cili realizon të hyra në shtetin burimor do të trajtohet ashtu siç kërkon marrëveshja konkrete. E cila po ashtu mund të dalloj në varësi nga:
   a) Afati i kontratës/punësimi i personit; nëse kohëzgjatja e angazhimit te personit nuk tejkalon 183 dite, atëherë ai tatohet në vendin e rezidencës, dhe nuk është i obliguar të tatohet në shtetin burimor;
   b) Lloji i shërbimeve; në këtë dallon varësisht se a është ai lloj i shërbimit përsëritës apo kryhet vetëm një herë.

   Në rast se personi fizik jo rezident kalon periudhën e përcaktuar (183 ditë) të qëndrimit dhe angazhimit në Kosovë atëherë kompania e cila ka angazhuar atë person ka për obligim të bëj

deklarimin dhe pagesën e tatimeve sipas legjislacionit në fuqi, bazuar në Kontratën e punësimit apo për kryerjen e shërbimeve në atë vend.
Lidhur me pagesën e tatimeve në Kosovë për personat jo rezident, nëse nga ai kërkohet dëshmi për pagesën e tatimeve atëherë vërtetimin tatimor e lëshon ATK.

2) Në rastet kur **nuk kemi METD**: atëherë e drejta tatimore përcaktohet me legjislacionin vendor në fuqi.

Procesi i përcaktimit të statusit të rezidencës për qëllime tatimore është e rregulluar me dispozitat e Nenit 4 të Marrëveshjes për Eliminim të Tatimit të Dyfishtë.

Të ardhurat e një rezidenti me burim nga jashtë
Kur një rezident i Kosovës, i cili realizon të ardhura nga një vend me të cilin **nuk kemi marrëveshje për eliminim të tatimit të dyfishtë** dhe kur ato të ardhurat janë tatuar në atë vend, me qëllim të eliminimit të tatimit të dyfishtë, ligji për tatimin mbi të ardhurat personale dhe atë të korporatave përcakton një zbritje tatimore ekuivalente me normën tatimore që do të paguhej në Kosovë.
Ndërsa në rastet kur rezidenti i Kosovës ka **realizuar të ardhura në Shtetin me të cilin Kosova ka Marrëveshje** për eliminimin e tatimit të dyfishtë ne te ardhura dhe parandalimin e evazionit dhe shmangies se fiskale, pjesa e atyre të ardhurave mund te mos do të tatohet në Kosovë. Në rastet kur të ardhurat tatohen jashtë, ky rezident do të dëshmojë me dokumentin valid të lëshuar nga autoriteti tatimor i vendit burimor të të ardhurave dhe në vendin e rezidencës është i liruar nga tatimimi, apo aplikohet krediti tatimor për pjesën e cila është paguar ne vendin tjetër.

Lidhur me termin banor apo rezident sipas METD, nënkuptohet banori i cili është rezident i një shteti kontraktues, i cili është i nënshtrohet obligimeve tatimore në atë shtet në bazë të shtetësisë, vendbanimit etj.

Jo rezidentët afarist (ndërmarrje/biznese)
Sa i përket të drejtës tatimore të ndërmarrjeve të cilat janë të huaja dhe ofrojnë shërbime apo aktivitete biznesore në vendin tonë ato trajtohen varësisht nëse kanë krijuar Njësi të Përhershme (NjP), apo operojnë në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera të cilat bien në paragrafët të përjashtuar për krijimin e NjP dhe Neneve të tjera të cilët lirohen nga tatimimi në vendin burimor.

Kriteret për krijimin e NjP janë:
- Vend fiks i biznesit, adresa, llogaria bankare ose prezenca tjetër fizike;
- Afati kohor (183 dite brenda 12 muajve) për krijim të NjP nën ligjin vendor apo marrëveshjes;
- Kontrolli aktual dhe drejtimi i veprimtarisë së punëtorëve nga kompania amë.

Një biznes i huaj i cili ka një vend ku zhvillon aktivitetin e tij fizik në Kosovë (vendi burimor) apo edhe nëse në formë tjetër virtuale, përmbush afatin kohor për krijim të NjP (varësisht nga marrëveshjet konkrete dhe veprimtarisë) apo edhe mënyrën se si janë angazhuar në atë biznes

punëtorët nga njësia amë, janë elemente që përcaktojnë krijimin e NjP dhe me këtë edhe të drejtën e tatimimit.

Në parim, të ardhurat nga fitimet biznesore të një ndërmarrjeje të huaj do të tatohen në Kosovë nëse krijon NjP në të kundërtën ato të ardhura nuk tatohen në Kosovë. Këto të ardhura do të tatohen në shtetin e rezidencës së ndërmarrjes.

Të ardhurat pasive si dividenta, interesi dhe të drejtat pronësore, në rastet kur ndërmarrja (marrësi i të ardhurave), është rezident i vendit me të cilin Kosova ka METD atëherë shkalla e tatimit për ato të ardhura nuk duhet të tejkalojë normën e tatimit të përcaktuar në Marrëveshje.